



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 10.03.2012, ora 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu

Mungoi: Goran Marinković, Rasim Demiri, Emin Gerbeshi

Përbërja e delegacionit nga Shqipëria: Ministri i Punëve të Brendshme të Shqipërisë, z. Bujar Nishani, Drejtori i Kabinetit, z. Aleksander Çavo, Drejtori i Përgjithshëm në MB, z. Isuf Çelaj, zv. Drejtori i Policisë së Shtetit, z. Pëllumb Nako

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Takim i Komisionit me Ministrin e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

Kryetari i Komisionit- Uroi mirëseardhje për delegacionin nga Shqipëri dhe prezantoi punën dhe përbërjen e anëtarëve të Komisionit.

Komisioni ka funksion të përpunimit i ligjeve të sjella nga Qeveria, ndërsa në seanca paraqiten pikëpamjet sipas karakterit politik të partive.

Si fillim ju njoftoj me punën e bërë gjatë vitit 2011 pran këtij Komisioni, janë aprovuar 13 ligje të rëndësishme për funksionimin e legjislaturës në Kosovë kjo pasi është dashur të zëvendësohen rregulloret e UNMIK-ut për funksionimin e institucioneve të Kosovës.

Për vitin 2012 kemi vetëm 4 ligje që do të shqyrtohen nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, dhe fokusi do të jetë në monitorimin e implementimit të ligjeve.

Puna e Komisionit është shërbyer nga përvoja e Shqipërisë si dhe shteti i Sllovenisë dhe i Gjermanisë, ku kjo e fundit ka luajtur rol të rëndësishëm në mbështetjen e fushës së sigurisë në Kosovë.

Në Raport me Ministritë që i mbikëqyrim kemi qenë racional si për Ministrinë e Punëve të Brendshme ashtu dhe Ministrinë e FSK-së, dhe kritikën e bëra kanë qenë përmbajtësore dhe jo të njëanshme.

Një çështje e rëndësishme që nuk e anashkalojmë në asnjë takim është situata në Veri të Kosovës qoftë me Ministrinë përkatëse ose në takime të tjera që bëhen nga Komisioni, pasi në këtë pjesë ende nuk ka një qeverisje nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjë e cila është neglizhuar nga faktori ndërkombëtar.

Ministri i Punëve të Brendshme i Shqipërisë, z. Bujar Nishani- Falënderoi të pranishmit për mikpritjen dhe vlerësoi bashkëpunimin e arritur mes dy Ministrive të Brendshme, të Shqipërisë dhe të Kosovës, duke arritur një standard të mirë dhe me rezultate konkrete.

Ashtu siç funksionon Komisioni juaj, harmonia ekziston edhe në Komisionin për Siguri në Republikën e Shqipërisë dhe kjo në funksion të arritjes së rezultateve konkrete në këtë fushë, duke evituar debatet politike.

Në fushën e bashkëpunimit ndërmjet dy Ministrive kemi modelin më të mirë të bashkëpunimit në të gjithë rajonin duke arritur kështu në standarde të disa vendeve anëtare të BE-së, si në menaxhimin e situatave, luftës ndaj organizatave kriminale ku përfshihet trafiku i armëve, trafikut të lëndëve narkotike të cilat mbështesin sfida në çështjen e sigurisë.

Në takimin e Ministrin e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, z. Bajram Rexhepi kemi diskutuar për çështjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek qytetarët si të Republikës së Kosovës ashtu edhe të Shqipërisë. Dua të ju garantoj që përmes këtij bashkëpunimi që kemi arritur kemi krijuar një imazh të shteteve dhe administratave funksionale duke i adresuar sfidat që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë.

Bashkëpunimi duhet të përmirësohet, sidomos në menaxhimin e pikave të kalimit kufitar. Z. Bajram Rexhepi i kam propozuar që të gjitha pikat e kalimit që kanë ekzistuar historikisht në mes Kosovës dhe Shqipërisë të bëhen funksionale sidomos për qytetarët, gjithashtu aplikimi i pikave të përbashkëta kufitare.

Nga viti i kaluar(2011) praktika e një pike të përbashkët ka funksionuar duke hedhur poshtë dyshimet e skeptikëve. Si rezultat i kësaj u bë standardizimi i procedurave, gjatë periudhës korrik- gusht ku fluksi i lëvizjes është i madh, është arritur identifikimi i nëntëdhjetë personave në kërkim, duke treguar efikasitet në funksionim. Një pikë kontrolli ekziston edhe me shtetin e Malit të Zi, të njëjtën gjë i kemi ofruar edhe Maqedonisë kjo në funksion të mirëfunksionimit dhe reduktimit të kostove.

Në aspektin e procesit të liberalizimit të vizave, ku në këtë proces tashmë hynë edhe Kosova, shteti shqiptar ka eksperiencë si në aspektin e legjislacionit si dhe në ngritjen dhe implementimin e sistemeve, siç është sistemi i analizës së riskut për krimin e organizuar , i quajtur **MEMEX** si dhe sisteme të tjera që janë instaluar në Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë, Drejtoritë e Qarqeve, dhe për këtë të gjithë specialistët dhe drejtuesit e sektorëve të sigurisë janë të mirëpëritur për të marrë nga këto eksperiencë.

Ju falënderoj për mbështetjen dhe bashkëpunimin që jepni në fushën e sigurisë si Parlament, dhe ky bashkëpunim është i nevojshëm dhe pavarësisht që ekzistojnë dy administrata kjo nuk duhet të pengoj në shkëmbimin e eksperiencave dhe ndërtimin e funksioneve të përbashkëta.

Me bashkëpunëtorët u njoha edhe me disa çështje që i kanë shqetësuar qytetarët e Kosovës gjatë vizitave në Shqipëri sidomos problematikat me Policinë e qarkullimit rrugor të cilët në disa raste kanë implementuar procedura të paligjshme. Për këtë qëllim si Ministër në vitin e kaluar(2011) kam lëshuar një urdhër që i ndalohej policisë të ndalonte për çdo lloj kontrolli mjetet me targa të Kosovës.

Në takim me z. Bajram Rexhepi i propozova që do të gjemë një zgjidhje që për të gjitha ata që e shkelin ligjin do të evidentohen, penalizohen dhe informacioni ti përcillet Policisë së Kosovës kjo në funksion të lehtësisë për qarkullimin e qytetarëve të Kosovës për në Shqipëri.

Dua të ju garantoj që bashkëpunimi në fushën e sigurisë, luftës ndaj kriminalitetit mbete një prioritet, ju falënderoj për mbështetjen në këtë fushë dhe mund të them që këto dy vende eksportojnë siguri për të gjithë rajonin, kjo si rezultat i një bashkëpunimi pa dallime politike që mbështesin agjensionet për siguri.

Ju falënderoj për mikpritjen dhe ju garantoj që do të ketë gatishmëri nga Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e shtetit për të bashkëpunuar në fushën e sigurisë.

Rexhep Selimi- Komisioni vepron me politika që e mbështesin fushën e sigurisë, e vlerësojmë dhe e mbështesim bashkëpunimin e Ministrisë së Punëve të brendshme të Shqipërisë dhe MPB të Kosovës, ky bashkëpunim duhet të vazhdojë në mënyrë që kufiri mos të jetë pengesë. Policia është mekanizmi që e lehtëson qarkullimin e qytetarëve, pengesat vazhdojnë të paraqiten por përmes bashkëpunimit duhet ti evitojmë.

Një çështje tjetër është edhe bashkëpunimi në shkëmbimin e informacionit mes Shqipërisë, Kosovës dhe Interpolit, por informacionet që posedojnë në kufirin shqiptarë janë listat e të kërkuarve nga Serbia, kjo nuk është mirë për imazhin dhe marrëdhëniet e mira që ekzistojnë mes nesh. Këto lista do të ishte mirë që të mos figuronin mes kufirit shqiptar. Mbështes idenë për vendkalime të tjera kufitare që do të krijonin lehtësi në qarkullim edhe ndoshta në heqjen e tyre.

Ministri, Bujar Nishani- Do të bëjmë një zgjidhje që për të gjithë personat që kanë flet arrest nga Serbia për çështjen e Kosovës, të hiqen nga lista në mënyrë që mos të ketë pengesa gjatë kalimit të kufirit.

Fatmir Xhelili- Eksperiencat e marra nga Shqipëria për funksionimin e instrumenteve të sigurisë, administratës dhe ligjet kanë shërbyer si model. Segmentet e sigurisë kanë avancuar duke arritur kështu standarde të avancuara evropiane.

Përvojat e marra nga shteti shqiptar, plan programe me specifika të veçanta kanë kontribuar në avancimin e këtyre mekanizmave por, edhe eksperiencat e vendeve të zhvilluara të ofruara për Kosovën në këtë fushë duhet të shërbejnë edhe për shtetin shqiptar.

Ne jemi në drejtimin e duhur dhe kjo ka ndikuar në hapat e mëtutjeshëm dhe fazat para procesit të aderimit në Bashkimin Evropian. Eksperiencat e shtetit shqiptar do të shërbejnë pozitivisht për Kosovën, pasi me efikasitet dhe shpejtësi keni arritur standardet për të hyrë në proces të liberalizimit.

Bujar Nishani- Eksperiencat janë të dyanshme, e theksoj arsimin bazë policor, kjo është një arritje dhe kjo do të shërbente si përvojë për shtetin shqiptar.

Kryetari i Komisioni- Edukimi i Policisë së Kosovës është i rregulluar me ligj, përvojat e shteteve mike të Kosovës kanë kontribuar në këtë drejtim dhe kjo ka ndikuar që Policia e Kosovës është e edukuar.

Ju falënderoj për vizitën , Komisioni do të ketë një vizitë në Shqipëri si vazhdimësi e bashkëpunimit të dyanshëm, gjithashtu falënderoj mbështetjen e dhënë edhe nga Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë për këtë bashkëpunim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi